

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Isuf Makolli, dhe procesmbajtësin Fatmir Gashi, në çështjen penale, kundër të pandehurit E.A, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.7093/2015, të datës 25.02.2015, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit të datës 05.09.2016 për dhënien e Urdhrit Ndëshkimorë –Dënim me gjobë, gjykata jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 07.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.7093/2015, të datës 05.09.2016, dhe gjykata shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I akuzuari **E.A**, i biri i J dhe A e gjinisë M i lindur me *data e lindjes*, në I, me vendbanim në rr.”D” A. H-.nr., në F K, student, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. Personal *numer personal*, nofka “B”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR**S e p s e:**

Me datë 19.11.2015, rreth orës 23:25, në rrugën “A K” në P i pandehuri E.A së bashku me shokët e tij L.B dhe T.H ishte ndal nga policia dhe gjatë kontrollit nga ana e policisë, tek i pandehuri në xhepin e vogël të pantallonave nga ana e djathtë është gjetur një sasi me substancë narkotike e llojit kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol me peshë të përgjithshme prej 0.46gram, të cilën i pandehuri e ka poseduar pa autorizim,-

-me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së

Andaj gjykata konform neneve:4,7,17, 21,43,46, 73 të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **400 € (katërqind Euro)**, të cilin dënim me gjobë, i akuzuari, obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre(3) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi- urdhri ndëshkimor.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund t’ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, duke i llogaritur nga një(1) ditë burgimi për 20 € të gjobës.

Nga i akuzuari konfiskohet substanca narkotike e llojit mariuhan në sasi prej 0.46 gram.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do te jen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **njëzet (20) €**.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.7093/2015, të datës 25.02.2016 e ka akuzuar E.A, për shkak të veprës penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, dhe nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptoi Urdhrit Ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me arsyetimin së ka prova të besueshme në shkresat e lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstaton se provat e bashkangjitura propozim akuzës në shkresat e lëndës, dhe atë: Kallëzim penal nr.2015-AB-3355, i datës 02.12.2013; Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të sendeve; Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit; Urdhëresa e policisë së Kosovës- njësia kosovare për forenzikë për ta bërë ekzaminimin forenzik të substancave të dyshuara narkotike të cilat i janë konfiskuar të akuzuarit; Raporti i ekspertimit nr.2015-AB-3355 i datës 15.02.2016, ku është konstatuar se ekzaminimi i substancës bimore me ngjyrë të gjelbër nga dëshmitë #1 dhe 1.1 ka treguar se është prezent Kanabisi (Marihuana) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC); Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dyshuarin , ku edhe vet i akuzuar e ka pranuar se marihuana i është gjetur atij, të cilën e kishte blerë nga një person në Prishtinë mbi Pllato te Bororamizi të cilin thot se nuk e njeh, si dhe shkresat tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, për të cilën është akuzuar dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi-Urdhri Ndëshkimor.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450, të KPPK.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike e llojit marihuan me peshë prej 0.46 gram u muar konform nenit 115 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.892/2016, datë 07.09.2016.

Procesmbajtëse,
Fatmir Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Isuf Makolli

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.